



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0348

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Agon Ramadani - Anëtar dhe Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE GRANITI SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, Vendimin për dhënie të një kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit “Kolonja e artisteve faza II-inventar dhe pajisje tjera” me numër të prokurimit 631-23-3039-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN, më 13/07/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik “Graniti” Sh.P.K.- Suhareke, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 05.06. 2023 (me numër protokolli 348/2023) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Kolonja e artisteve faza II-inventar dhe pajisje tjera “ me nr. të prokurimit: “631-23-3039-1-1-1”, inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Decan.

2. Mbetet në fuqi, Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull: “Kolonja e artisteve faza II-inventar dhe pajisje tjera “ me nr. të prokurimit: "631-23-3039-1-1-1", inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Decan.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues është refuzuar si e pabazuar, të njëjtit i konfiskohet tarifa që ka paguar me rastin e parashtrimit të ankesës konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e RKS-së.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 31.03.2023, Komuna Decan në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Kolonja e artisteve faza II-inventar dhe pajisje tjera“ me nr. të prokurimit: “631-23-3039-1-1-1”.

OE “Graniti” shpk me datën 29.05.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 31.05.2023, AK- Komuna Decan me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Graniti” shpk, me datën 05.06.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 348/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës:210.000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 08.06. 2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e operatorit ekonomik ankues të refuzohet si e pabazuar.
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin në këtë aktivitet të prokurimit të operatorit ekonomik ankues, se në lidhje me letrën standarde për informata mbi tenderët jo normalisht të ulët që ju na keni dërguar neve, ju sqarojmë se ne si kompani për shkak të një lëshimi teknik nga ana jonë nuk e kemi parë letrën standarde të cilën na keni dërguar dhe për këtë arsye nuk ju kemi kthyer përgjigje.

Ndërsa sa i përket njoftimit mbi vendimin të cilin e keni publikuar me dt.23.05.2023, ju sqarojmë se ju nuk keni vendosur ndonjë arsye të eliminimit mirëpo vetëm e keni publikuar letrën standarde për informata mbi tenderët jo normalisht të ulët.

Nëse e keni menduar si arsye të eliminimit faktin se nuk ju kemi kthyer përgjigje, ju sqarojmë se ky arsyetim nuk mund dhe nuk duhet të qëndroj dhe njëkohësisht e njëjta është e pa bazuar, për

faktin se jemi të gatshëm të përfundojmë këtë kontratë me çmimet me të cilat kemi ofertuar.

Ndërsa se si ne kemi ardh në përfundim që të ofertojmë me çmimin me të cilin kemi ofertuar, së bashku me këtë kërkesë për rishqyrtim do të ju bashkangjesim dokumentin ku i kemi sqaruar çmimet për secilin pozicion, pra kemi dhënë sqarime detale për secilin nga pozicionet. **(Bashkangjitur gjeni sqarimin për çmimet me të cilat kemi ofertuar).** Këtë sqarim e kemi bashkangjitur edhe me kërkesë për rishqyrtim.

Gjithashtu ju sqarojmë se asnjëra nga çmimet me të cilat kemi ofertuar ne, nuk janë çmime manipulative, mirëpo janë të analizuara mirë nga ana jonë, ku edhe kemi ardhur në përfundim që të ofertojmë me këto çmime.

Andaj ne ju informojmë se qëndrojmë në tërësi pranë të gjitha çmimeve të dhëna në të gjitha pozicionet dhe ju garantojmë se ne jemi në gjendje të përmbushim këtë kontratë ashtu siç është kërkuar dhe ashtu siç kemi ofertuar me ato çmime.

Gjithashtu ne jemi në gjendje të pranojmë edhe rritjen e sigurimit të ekzekutimit aq sa ju e shihni të arsyeshme edhe 20% apo 30 %, si garancion se ne mund ta përfundojmë këtë projekt me kohë dhe në mënyrë profesionale me çmimet që ne i kemi ofruar.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, AK me datë: 08.05.2023 ora: 15:15 ka ngarkuar në letër standarde e kërkesë për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët për OE ankues, po citoj si ne vijim:

OE: GRANITI SH.P.K. Rr. Ibrahim Rugova p.n. 23000, Shirokë, Suharekë, Gjate vlerësimit të tenderit komisioni i vlerësimit ka konstatuar se duke u bazuar në çmimin e ofertës në krahasim me vlerën e parashikuar të këtij projekti është 106,975.00 € me i ulët, ndërsa 26,333.25 € me i lirë se tenderuesi tjetër me i lirë. Andaj duke u bazuar në: UDHËZUES NR. 001/2023 PËR PROKURIM PUBLIK

11. Tenderët Jo-normalisht të Ulët

11.1 Në çdo rast kur tenderët duken jo normalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues do të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

1. Janë pranuar me shume se 3 oferta

2. Çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm.

3. Çmimi i ofruar është me shume se 10% me i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët.

Andaj është Jo-Normalisht i ulët për këtë tender.

*Informatat e kërkuara duhet të pranohen **me shkrim** në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues, ose në numrin e fax-it [shëno numrin e faksit] apo në e-mail: prokurimi.decan@rks-gov.net brenda 5 ditëve nga data e kësaj kërkesë. Nëse nuk marrim përgjigje nga ju mbi pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të dhënë, tenderi juaj do të refuzohet.*

Mirëpo, OE ankues ashtu siç e ka deklaruar edhe vet ne deklaratën detale mbi faktet dhe argumentet se nuk përgjigjur po citoj: “*ju sqarojmë se ne si kompani për shkak të një lëshimi teknik nga ana jonë nuk e kemi parë letrën standarde të cilën na keni dërguar dhe për këtë arsye nuk ju kemi kthyer përgjigje*”, prandaj bazuar ne **nenin 41. 7 te Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimi Publik**, ku thotë: “*Operatori Ekonomik do ti përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet*”, dhe AK – komisioni i vlerësimit, ZPP kanë vepruar sipas këtij neni te Rregullores për Prokurim Publik, prandaj lidhur me këtë pretendim duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm**.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **ka respektuar nenin 59 dhe 61 të LPP-së**, andaj, **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP**, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore të LPP-së, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në

vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar se në raportin e ekspertizës së tij.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara shkurtimisht si më sipër në shkresat e kësaj lënde nuk gjendet ndonjë provë se AK ka aplikuar ndonjë kriter apo veprim që diskriminon, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik.

- Përfundim -

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër të LPP dhe ka zbatuar drejtë dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 27, sipas të cilit, autoriteti kontraktues përpilon dosjen e tenderit me të gjitha informatat përkatëse përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Në kuptim të kësaj dispozite, dosja e tenderit përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplisit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN, KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN**
- **OE - GRANITI SH.P.K., GRANITI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: